



**SHKPKK**

Shoqata Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave Komunale

www.shkpkk.org

# Kurora e Gjelbër



Gazetë e Shoqatës Kombëtare të Pyjeve dhe Kullotave Komunale, Tiranë (Viti i njëmbëdhjetë i botimit) Nr. 85, shtator-tetor 2008 Çmimi 20 lekë

## TRANSFERIMI, REFORMA KRYESORE NË PYJE

Kalimi i fondit pyjor në varësi të komunave dhe bashkive është një ndër reformat më të mëdha që ka bërë vendi ynë gjatë 18 viteve të fundit, pas privatizimit të tokës bujqësore. Kështu e ka vlerësuar ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Prof. Lufter Xhuveli, në një intervistë për "KJ". Sipas tij, me këtë reformë do t'u jepet mundësi banorëve, por edhe vetë komunave e bashkive që të shtojnë të ardhurat, si dhe të përmirësojnë cilësinë e mjedisit. Nga ana tjetër, kjo Ministri ka venë në dispozicion të ish-pronarëve rreth 42 mijë ha pyje, që do të shërbejnë për kompensim.

Për të informuar më mirë lexuesit e saj, Gazeta "Kurora e gjelbër", organ i Shoqatës Kombëtare të Pyjeve e Kullotave Komunale, po boton pothuaj të plotë bisedën e Ministrit Xhuveli me F. Ferkon.



**Ju keni përfunduar kalimin e të gjithë fondit pyjor në varësi të komunave e bashkive, ç'do të thotë kjo?**

Ka pothuaj tre vjet që punohet për një reforme të plote në sektorin e pyjeve, e cila është përqendruar në disa politika të reja, politika që tashmë janë shndërruar në vendime të KM dhe në ligje, nderkohe që janë në proces zbatimi. Me dy fjale do të thosha edhe shtyllat kryesore të politikave të reja dhe të kesaj reforme në sektorin e pyjeve kanë të bëjnë, se pari, me transferimin masiv të pyjeve e kullotave nga shteti në pronësi të komunave e bashkive. Së dyti, duke rritur sipërfaqen e Zonave të Mbrojtura dhe të Parqeve Kombëtare

me objektivin për të arritur pas pak viteve mesataren e këtyre sipërfaqeve me ato të vendeve të BE. Mund të them që është dyfishuar sipërfaqja e Zonave të Mbrojtura, brenda këtyre tre vjeteve, nga 5.4 % që ka qene në vitin 2005, në 11.4 % në qershor të këtij viti, kurse mesatarja e vendeve të BE-se është 17 % dhe besoj që nga vitin 2012 apo 2013, do të kemi arritur këtë mesatare. Së treti, është ulur dukshëm sipërfaqja e pyjeve që shfrytëzohen apo priten mbi bazen e lejeve, mbi bazen e planeve të menaxhimit dhe shumë me tepër prerja e paligjshme e pyjeve, prerje që akoma nuk është ndaluar plotësisht, por është ulur dukshëm. Për ta konkretizuar këtë, do të doja të përmend dy shifra. Në vitet 2000-2005, mbi bazen e planeve të menaxhimit, priteshin 335 - 350 mijë m<sup>3</sup> lende, aktualisht nuk planifikohet më shumë se 100-120 mijë m<sup>3</sup> në vit, pra tri herë më pak dhe kjo do të thotë sipërfaqe me e

Faqe 4



## Një delegacion suedes i pyjeve në Shqipëri

Prof. Dr. ARSEN PROKO

Faqe 5

## FUNDI I PYLLTARISË NË SHQIPËRI

Prof. Dr. Anesti POSTOLI; Prof.As. Dr. Vath TABAKU  
Prof. Dr. Mihallaq KOTRO; Prof.As. Dr. Vasillaq MINE

Fakulteti i Shkencave Pyjore në UB të Tiranës

Në këtë artikull do të bëjmë fjalë për një aktivitet njerëzor sa të rëndësishëm aq dhe të shpërdorur, sa të vjetër e të njohur aq edhe të injoruar e të lënë pas dore, për pyllta-

rinë, që në gjuhën teknike gjithë bota e quan silvikulturë, e cila sot rrezikohet të mbarojë krejtësisht. E shpjeguar

Vijon në fq. 2

**Shënim:** Mendimet e paraqitura në këtë artikull nuk shprehin qëndrimin apo pozicionin e SHKPKK



## Shoqata Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave Komunale anëtare e Konfederatës Europiane të Pronarëve të Pyjeve Privatë

SHKPKK është anëtare e Konfederatës Europiane të Pronarëve të Pyjeve Privatë (KEPPP - CEPF). KEPPP është përfaqësuese e pylltarisë familjare të Europës dhe ka për qëllim të shtojë vlerat e pronave private të pyjeve nëpërmjet menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve. KEPPP asiston për të forcuar shoqatat kombëtare të pronarëve të pyjeve në Europë, për të mirëmbajtur e shtuar një menaxhim të dobishëm nga ana ekonomike, me fitime sociale, me vlera kulturore, të përgjegjshëm nga ana ekologjike dhe të qëndrueshëm. KEPPP përfaqëson 16 milionë pronarë pyjesh privatë, që kanë në pronësi afërsisht 100 milionë hektarë pyje në 24 vende Europiane, ku përfshihet edhe Shqipëria.

Të nderuar lexues, Gazeta "Kurora e gjelbër", organ i SHKPKK, ju njeh me veprimtarinë e shoqatave dhe federatave të ngritura në gjithë vendin. Ajo trajton probleme që kanë të bëjnë me njohjen e ligjshmërisë dhe mendime për ta bërë sa më bashkëkohore këtë ligjshmëri.

Në faqet e kësaj gazete do të gjeni artikuj që trajtojnë përvojat më të mira të shoqatave e federatave. Po ashtu, do të gjeni edhe mjaft artikuj teknikë, që kanë të bëjnë me punën e përditshme në pyje e kullota e veçanërisht në ato që u kanë kaluar komunave e fshatrave.

Siç edhe e keni venë re, në këtë gazetë vijnë mjaft firma të gjohura, nga Ministria e Mjedisit për pyjet, nga Fakulteti i Inxhinierisë

SHOQATA KOMBËTARE E PYJEVE DHE KULLOTAVE KOMUNALE

NATIONAL ASSOCIATION OF COMMUNAL FOREST AND PASTURES



www.shkpkk.org

Pyjore, nga Projektet që veprojnë në sektorin e pyjeve, nga drejtues të Shoqatave të Pyjeve dhe specialistë të Shërbimit Pyjor nga gjithë vendi, gjë që ia ngre nivelin gazetës.

Nisur nga fakti që aktualisht Gazeta "Kurora ..." është i vetmi organ periodik shtypi për pyjet e kullotat, bëhen përpjekje që në faqet e saj të shkruhet historiku i këtij sektori, të njihet ecuria në vite, të njihen ata që kanë kontribuar, të nji-

hen arrijtjet e mosarritjet, që të ecet më me siguri në të ardhmen.

Nuk kanë munguar edhe artikujt që na njohin me zhvillime të pylltarisë botërore.

Tashmë, prej disa muajsh Gazeta "Kurora ..." ka zënë vend edhe në faqen e Internetit të hapur për SHKPKK, ku sigurisht, do të gjeni më shumë informacion për Shoqatat e Federatat, si dhe për Shoqatën Kombëtare.

Ju ftojme të klikoni në adresën: [www.shkpkk.org](http://www.shkpkk.org)

# FUNDI I PYLLTARISË NË SHQIPËRI

Vijon nga fq. 1

shkurt, silvikulturë (ose pylltari) do të thotë “kulturë e pyjeve”, por do të ishte me shumë interes për ne të dihej ç’kuptim i japin këtij koncepti në Shqipëri shtresat e gjëra të popullit e në mënyrë të veçantë drejtuesit e lartë të shtetit, të ekonomisë, të shkencës, të kulturës, të medias, etj., me një fjalë, të gjithë ata që nuk janë specialistë të kësaj fushe, të cilët në fakt përbëjnë shumicën?

Fatkeqësisht, duke sinteti-zuar një përvojë afatgjatë tonën por edhe të të tjerëve, si edhe duke analizuar faktet reale që vihen re përditë, mund të arihet në përfundimin se shumica janë të mendimit se silvikultura bëhet thjesht “duke prerë e mbjellë drurë”. Një thjeshtësim i tillë intuitivisht të çon tek përfundimi se silvikulturën e bëjnë pylltarët, duke kuptuar me këtë thjeshtë njerëzit që punojnë në terren, në pyje, mjafton që ata të urdhërohen.

Jemi të mendimit se ky konceptim i silvikulturës ka bërë që sot në vendin tone në fushën e ekonomisë pyjore të mbahen qëndrime nga më absurdet e të bëhen veprime nga më të pa tolerueshmet në shumë drejtime. Kështu, duke konfunduar “mjedisin” vetëm me “pyjet”, shkëputen këto të fundit nga “Ministria e Bujqësisë” dhe krijohet një ministri e re me emrin “Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave”, duke harruar se mjedisi përbëhet jo vetëm nga pyjet, që përfshijnë vetëm një të tretën e territorit të vëndit, por edhe nga fushat e bujqësisë, kullotat, sipërfaqet shkëmbore e inproduktive, territoret e qëndrave të banuara, sipërfaqet e ujërave të brendshme e të linjave të transportit, sipërfaqet e plazheve e të qëndrave turistike, etj., të cilat përfshijnë dy të tretat e tjera të këtij territori. Harrohen gjithashtu atributet prodhuese të pyllit, mbi të cilat mbështetet në përqindjen më të madhe jetesa e mëse gjysmës së popullsisë së vëndit, që akoma jeton në zonat rurale, si përsa i përket furnizimit të saj me lëndë djegëse e ndërtimi, ashtu edhe për sigurimin e kullotës dhe rezervës ushqimore për dimer për blegtorinë ekstensive. Por, atributet prodhuese të pyjeve nuk lidhen vetëm me pjesën rurale të vëndit po edhe me pjesën e urbanizuar, d.m.th. me qytetet, transportin, sektorin e ndërtimit, industrinë e drurit, etj., të cilat në përqindje të ndryshme marrin prej pyllit lëndën e drurit.

Sigurisht, i trajtuar me teknikën e duhur silvikulturale, pylli si

ekosistem i veçantë është në gjëndje të plotësojë përveç funksionit të prodhimit edhe funksione të tjera, siç janë mbrojtja e tokës dhe ujërave, përmirësimi i parametrave ekologjikë të klimës, ruajtja e florës dhe e faunës, etj., të cilat lidhen në mënyra të natyrshme me vetë ekzistencën e tij si ekosistem kompleks e vetrregullues. Silvikultura si teori shkencore dhe si aktivitet praktik ka lindur pikërisht për të bërë të mundur që pylli të plotësojë në nivelin më të lartë të mundshëm të dy këto kategori funksionesh.

Veprimi tjetër i rëndësishëm i ndërmarrë nga shteti aktualisht është transferimi i pjesës dërrmuese të sipërfaqes së pyjeve të vëndit komunave, transferim i cili, jo vetëm që asnjëherë nuk u kuptua qartë nëse është në përdorim apo në pronësi, por edhe, duke patur parasysh mënyrën se si u bë, na duket i padrejtë, mbasi pyjet janë aktualisht pronë e shtetit, pra e të gjithë popullit dhe, për pasojë, duhen administruar si të tillë. Nuk është e drejtë që pa pyetur pronarin popull, të jepen pyjet e shtetit në përdorim apo pronësi, qoftë komunave qoftë ish-pronarëve për kompensim, siç po dëgjojmë të thuhet kohët e fundit, pa e motivuar qartë këtë veprim dhe pa e konkretizuar pastaj atë me dokumentacion të plotë hipotekor e kadastral dhe të drejtën ligjore të shitjes e blerjes.

Nuk ka se si të mos mendosh se ata që kanë të drejtë të marrin vendime i konsiderojnë këto veprime si procese të thjeshta, si ndarje trofesh mbas beteje, për të cilat nuk ka nevojë të mendohesh shumë gjatë, kur konstaton se të gjitha këto veprime radikale në pyje bëhen me një të rënë të lapsit, duke mos marrë mendimin e organizmave të specializuara, që vetë shteti ka krijuar në këtë fushë, duke vënë në krye të dikasterit të porsakrijuar, por edhe në shumicën e drejtorive të bazës specialistë jo të fushës, kur konstaton se komunat i morën e po i marrin pyjet në përdorim apo pronësi (!) pa u preokupuar fare nëse kanë ose jo specialistë të profilit, mbasi janë të bindur se ato dinë t’i trajtojnë vetë pyjet ose në rastin më të vështirë mund të konsultohen me teknikun e pyjeve të zones përkatëse.

Duke e konsideruar pylltarinë (silvikulturën) problem mjaft të thjeshtë, pra “prerje e mbjellje drurësh”, të gjithë janë në gjëndje të japin mendime për pyjet edhe për probleme kardinale, të gjithë e dine se si mund të zgjidhen pa

vështirësi ato, duke dhënë të gatshme receta absurde. Kështu, përballë sakrifikimit pa shumë dhimbje të sipërfaqeve të tëra të pyjeve natyralë, vendosen, në kronikat televizive, “mrekullitë” që bëhen gjatë muajit të pyjeve me mbjelljen e disa drurëve në kodrat afër ndonjë qyteti, ndonjëherë edhe me pjesëmarrjen e udhëheqjes së Ministrisë, mrekulli këto që për komitetin e mënyrës se si kryhen demonstronjë më së miri intuitën tonë. Vetëm ekzistenca e një konsiderate të tillë për silvikulturën do ta motivonte privimin e Fakultetit të Shkencave Pyjore, për të marrë pjesë në tendera projektesh, të cilët tek ne praktikisht i fitojnë vetëm disa të ashtuquajtura “kompani” private, që shpesh kanë në krye persona me nivel tepër të ulët teknik.

Në të vërtetë ky opinion është krejtësisht i gabuar. Në “Fjalorin terminologjik të bujqësisë”, “pylltaria” (pra silvikultura) quhet degë e shkencës së bujqësisë, pra “Shkencë që studion kultivimin dhe konservimin e pyjeve”. Ajo nuk është thjesht një aktivitet praktik, por është në radhë të parë disipline shkencore, e bazuar mbi parime bioekologjike. Teknika silvikulturale që zbatohet në praktikë rrjedh nga përkthimi rigoroz në norma të kultivimit e konservimit të pyjeve, të ç’ka është arritur nga studimi, kërkimi dhe eksperimentimi afatgjatë në këtë fushë. Nëse është kështu, atëherë si mund të jepen zgjidhje të nivelit strategjik për ç’ka duhet bërë në pyje, si mund të ndërhyhet praktikisht me prerje, shpyllëzime, prodhim gjethi, apo kullotë vetëm me urdhra administrative, duke vënë në krye të këtyre punimeve vetëm pylltarë të terrenit, pa studiuar më parë efektet që do të kenë këto veprime mbi ekosistemin, rikuperimi i të cilave është në shumicën e rasteve i pamundur mbas ekzekutimit. Megjithë respektin për pylltarët e terrenit, të cilët janë punonjës të domosdoshëm, që japin kontribut me vlerë absolute përsa i përket anës praktike, është e detyrueshme të themi se nuk është kurrësi e drejtë të veprohet kështu. Nëse do ta konsideronim të drejtë këtë veprim, do të ishte njëllë sikur të thoshim që infermierët janë ata që bëjnë klinikën mjekësore dhe muratorët shkencën e ndërtimit.

Në të vërtetë, në fillimet e tij njeriu e përdori pyllin në mënyrë të pakufizuar dhe vetëm kur burimet pyjore filluan të jenë të pamjaftueshme në zonat më të zhvilluara të globit, lindi silvikultura,

lindën metodat e qeverisjes dhe trajtimit të pyjeve, që përbëjnë esencën e saj, nëpërmjet të cilave sigurohet vjelja nga pyjet e materialit drusor dhe e prodhimeve të tjera pyjore, duke garantuar njëkohësisht vazhdimësinë e mbulesës pyjore, e cila në fakt përbën “makinen” e procesit të prodhimit pyjor.

Nga ky vështrim, edhe në silvikulturë, sikurse në çdo fushë tjetër të prodhimit, bëhet fjalë për prodhim, rendiment, kosto, fitim, investim etj., kategori këto të përgjithshme të fushës së ekonomisë, me karakter esencial e polivalent, që kanë në bazën e tyre procesin e shfrytëzimit të pyjeve, i cili në çdo rast në mënyrë të natyrshme duhet të jetë i leverdisshëm e rentabël. Sigurisht, në kohët moderne vlerësohen në masë të barabartë, nganjëherë më të madhe, edhe atributet e tjera të pyllit, që nuk kanë të bëjnë me lëndën e drurit, por me efekte të tjera, të cilat megjithatë tentohet të maten nga ana sasiore, duke bërë përpjekje për përcaktimin e vlerës së tyre monetare, për ti futur edhe ato në ciklin e përgjithshëm të qarkullimit të vlerave.

Në të vërtetë, silvikultura me metodat e saj tenton ta bëjë pyllin funksional, të ruajë e shtojë biodiversitetin, të shpëtojë habitatet dhe të mbrojë bashkëveprimin midis ekosistemeve. Prerja e drurëve kryhet për ta bërë efikas pyllin, i cili është një sistem biologjik kompleks, d.m.th. sistem vetrregullues, i adaptueshëm e i përbërë, arsye për të cilat është rezistent e i qëndrueshëm. Pylli është fond me interes public, që duhet kujdesuar e mbrojtur ashtu sikurse kujdesohet, ruhet e mbrohet shtëpia personale. Arsyeja është lehtë për t’u shpjeguar: sepse nga funksionaliteti i sistemit pyll varet cilësia e jetës tonë dhe kjo është arsyeja përse nuk konstatohet fundi i pylltarisë.

Silvikultura nuk është vetëm dhe vetëm një aktivitet i pylltarëve, por është, mbi të gjitha, një aktivitet “ekspertësh”, që përdorin njohuritë më të mira shkencore për t’i ofruar një shërbim shoqërisë. Motosharra është një instrument njëllë si instrumentet e matjes, njëllë si mjetet teknologjike, njëllë si aparatet e laboratorit, njëllë si traktori për përgatitjen e terrenit për mbjellje dhe, pikërisht për këtë, ajo duhet përdorur nga pylltarët me kujdes, vazhdimësi e kapilaritet, gjithmonë nën drejtimin e inxhinierit të pyjeve, në interes të pyllit, sepse interesi i pyllit është edhe interesi i pronarëve, i punëtorëve pylltarë e, mbi të gjitha, i shoqërisë.

Sikurse afirmojnë shumica e silvikulturve më në zë të kohës “Ekziston një ndërveprim midis

strukture konceptuale të shkencës dhe realitetit, midis realitetit social dhe shkencës, i cili manifestohet në kompleksin e forcave, që vendosin cili është problemi dhe cila është zgjidhja e problemit”. Kështu, vendosi tek ne qeveria e para disa viteve të “ndërpresë” për 2-3 vjet shfrytëzimet dhe u krijua iluzioni se pyjet shpëtuan. Me këtë rast, u tha se pyjet na duhen paskëtaj vetëm për ajër të pastër e ekologji, paçka se nga njëra anë gjysma e popullsisë jeton në fshat, kurse nga ana tjetër, të gjithë duam të kemi në shtëpi mobilie druri. Thellohet ky iluzion në organizimin e ri të qeverisë aktuale me Ministrinë e Mjedisit, paçka se gati të gjitha pyjet iu kalohen komunave dhe dihet që ato nga njëra anë e duan pyllin thjesht për të plotësuar nevojat e tyre për lëndë druri, kullotë e prodhim gjethi, kurse nga ana tjetër nuk kanë as dijenitë as strukturat dhe as kuadrin e specializuar minimal për t’i marrë në dorëzim e për t’i mbarështuar ato. Dhe të gjitha këto kryhen nën drejtimin e një administrate të udhëhequr nga joprofesionistë të fushës, integralisht në nivelet e larta e pjesërisht në drejtoritë e bazës. Komedia është se Shqipëria edhe në këtë fushë ka ndërkohë plot njerëz me përvojë të gjërë kërkimore e prodhimi, ka profesorë e doktorë, fakultet e agjenci, drejtori e sektorë e, mbi të gjitha, qindra inxhinierë e teknikë, formimi i të cilëve në këtë mënyrë jo vetëm nuk motivohet, por po u vazhdua kështu pyje në kuptimin e vërtetë të fjalës nuk do të kemi dhe kjo mund të shënonte fundin e pylltarisë.

Silvikultura evoluon në lidhje të ngushtë me shoqërinë, me nevojat e saj, me përparimin e njohurive dhe, pse jo, me rritjen e kulturës. Një sugjerim do të bënim për ata që fati u dha në dorë skeptrin e vendimmarrësit për çdo fushë të veprimtarisë njerëzore edhe pse nuk i njohin të gjitha, të mos qëndrojnë autoritarë e të pandjeshëm në postet e komandimit, por të përpiqen të kuptojnë se “kohët ndryshojnë”, me fjalë të tjera të përpiqen të venë në jetë çdo gjë që propozon shkenca, duke aplikuar me zgjuarësi e saktësi silvikulturën moderne, d.m.th. atë silvikulturë për të cilën diskutohet në mjediset shkencore të auditorëve universitarë të fushës përkatëse e jo në mbledheje heterogjene e demonstrative komisionesh e komitetesh, workshop-esh e string-komitetesh, se janë duke e lënë vëndin pa pyje dhe kjo do të ishte një turp për ta dhe ne, mjerim për Shqipërinë dhe brezat që do të vijnë dhe fundi i Pylltarisë në vëndin tonë.

# SUGJERIME PËR PLANIN E MIKROBASENIT

nga MIHALLAQ QIRJO, koordinator Rajonal

**P**una voluminoze, shumëplanshe e me përfshirjen e shumë faktorëve dhe aktorëve, për hartimin e Planit të Mikrobasenit të Hudenishtit në Pogradec, na pasuroi me një përvojë të re e, njëkohësisht, na dha mundësinë të reflektojmë për vlerat e metodikës së përdorur. Pa dyshim që është dokument serioz, me vlera të përgjithshme të mira për menaxhim të qëndrueshëm të këtij mikrobaseni. Por, nisur nga përvoja e fituar, mund të sjellim edhe disa sugjerime për përmirësimin e punës e të përmbajtjes së një plani të tillë.

## Struktura e planit të Mikrobasenit

\* Si makrostrukturë, pra pjesët, kapitujt dhe renditja e tyre, sugjerojmë një shtesë: Pas pjesës së parë, përshkrimi të gjendjes ekzistuese dhe evidentimit të problemeve kryesore e para planifikimit të aktiviteteve, është mirë të **paraqiten kriteret e vlerësimit të gjendjes ekzistuese dhe prioritetet sipas radhës së tyre**. Kjo do të lehtësonte përcaktimin e aktiviteteve.

\* Skelet-plani i organizuar nëpërmjet 84 tabelave e anekseve, është voluminoz. Ai përgjithësisht është informativ, por duke qenë i mbingarkuar, kërkon shumë punë në terren dhe vështirëson nxjerrjen e përfundimeve. Prandaj, **për pjesën e parë sugjerojmë shkurtim të numrit të tabelave dhe rigrupim të përmbajtjes së tyre**. Më konkretisht, **tek të dhënat sociale e ekonomike të fshatrave, tek ato klimatike e në ndonjë rast tjetër**.

\* Riorganizim sugjerojmë për trajtimin shumëplanësh të burimit natyror kryesor, tokës. Konkretisht, shqetësim është studimi i tokës bujqësore. Këtu lypset evidentuar qartë toka e papërdorur, e ndarë në: tokë e papërdorur, që është pronë e fshatarit dhe **tokë e papërdorur e refuzuar**. Mbi këtë të dytën duhet përqendruar vëmendja jonë kryesore. Argumentimi: **Tokat e refuzuara, zakonisht janë më të cekëta, më të varfëra, më të pjerrëta dhe në kufij më të lartë. Janë tokat më të ekspozuara ndaj degradimit (prej mospërdorimit) dhe ndaj erozionit. Është pjesa e tokës, që më parë i ka takuar fondit të tokës**

**pyjore dhe që kundër funksionit natyror të saj është tentuar të trajtohet si tokë bujqësore. Nga ana administrative, këto toka është tentuar t'u jepen fshatarëve, por janë refuzuar prej tyre dhe, si të tilla, kanë mbetur jashtë vëmendjes së individit, të shtetit dhe shoqërisë.**

\* Element i domosdoshëm për leximin e kuptueshëm, të konkretizuar dhe për zbatueshmërinë korrekte të aktiviteteve, është **emërtimi i tokës jo vetëm si sasi, funksion, përkatësi, etj., por edhe me pozicionin e vet kadastral. Pra, në tabela, përkrah sasisë të shënohet numri i ngastrës (parcelës) apo nënndarjeve të tyre.**

## Planifikimi i aktiviteteve

\* Sugjerojmë që në radhë të parë, **aktivitete të planifikohen për tokat e refuzuara**. Vetkuptohet, kjo kërkon vullnetin e mirë të drejtuesve të komunës dhe Këshillit të komunës.

\* Aktivitetet e rekomanduara në skelet-plan për punimet në pyjet e kullotat,

thjesht të zëvendësohen me formulimin: **“Referojuni planit të menaxhimit të pyjeve e kullotave komunale dhe planit të mbarëshimit të ekonomisë pyjore që përfshihet tërësisht apo pjesërisht në Mikrobasen”**.

\* Në punimet e rekomanduara në fushën e bujqësisë e të blegtorisë, mbarëshimit i bletarisë, sugjerojmë **të mos përmbahet, pasi ky mbarëshim bëhet shumë mirë prej amatorëve të kësaj fushe**.

\* Evidentimi i aktiviteteve të nevojshme në Planin e Mikrobasenit të Hudenishtit (gjykuar edhe nga gjendja e përgjithshme rurale në vendin tonë) na çon në përfundimin se **një Plan i tillë, që të zbatohet e të realizojë qëllimin e tij kryesor, Menaxhimin e qëndrueshëm të Mikrobasenit, kërkon një financim 4 – 6 herë më të lartë se kuota e caktuar për të**. Përndryshe, efektet do të jenë jo të plota, me vlerë të ndjeshme disi për komunitetin, por me vlerë të pakët për zhvillimin e burimeve natyrore dhe gjenerimin e efekteve mjedisore pozitive.



nga SOKOL GURI  
Federata Rajonale, Shkodër

## Pas një vizite pune në Qarkun e Dibrës

Me ftesë të Federatës Rajonale të pyjeve e kullotave Dibër dhe me mbështetje nga SNV-ja Dibër, Federatat Rajonale të pyjeve e kullotave të Shkodrës dhe të Lezhës bënë një vizitë pune në Qarkun e Dibrës, për t'u njohur me organizimin dhe funksionimin e kësaj federate, si e para e krijuar në vendin tonë.

Në zyrat e SNV-së u njohëm me strukturat e Federatës, si dhe me një studim që SNV-ja, në bashkëpunim me Federatën, ka realizuar oër gjendjen e arroveve në Qarkun e Dibrës, pasi një studim i njëjtë është kryer edhe me mbështetjen e SNV-së në qarqet Shkodër e Lezhë. Vizita vazhdoi në zyrat e Federatës, ku u njohëm me organizimin e saj për të patur funksionim të qëndrueshëm e

gjithpërfshirës nga shoqatat e komuniteti dhe atë të pushtetit vendor, ku u shkëmbyen provokat e tri federatave.

Në terren u njohëm me zbatimin e disa projekteve të mbështetura nga donatorë të ndryshëm në disa komuna, ku u pa konkretisht si është arritur në përmirësimin e disa pyjeve. U njohëm dhe me një mënyrë për luftimin e sëmundjeve në pyjet me gështenja, mënyrë e thjeshtë por që mendohet se të jetë e frytshme.

Pas këtyre pak radhëve, s'mund të lemë pa përmendur mikpritjen dhe kujdesin e treguar për ne gjatë ditëve që qendruam në Dibër. Me këtë rast, një falenderim për stafin e SNV, Dibër, për Federatën Rajonale, për të gjithë ata përfaqësues të DSHP, Dibër që na shoqëruan.

## NJËSITË VENDORE REFUZOJNË

### “TË MARRIN” NË DORËZIM PYJET

Drejtues të njësive të qeverisjes vendore të qarkut të Shkodrës kanë paralajmëruar se nuk do të firmosin marrjen në dorëzim të sipërfaqeve pyjore, që me vendim të KM u kanë kaluar në

pronësi komunave. Shkak për këtë, sipas tyre, është mungesa e hartave territoriale të sipërfaqeve pyjore. Problemi është evidentuar gjatë një takimi të zhvilluar për këtë qëllim në zyrën e prefektit Maxhid

Cungu. Ky ka theksuar se kalimi i sipërfaqeve pyjore në pronësi të komunave e bashkive ndikon pozitivisht në menaxhimin e tyre, ruajtjen dhe shfrytëzimin në dobi të komunitetit, si dhe përkon me reformën e decentralizimit të pushtetit vendor. Por, kryetarë të komunave të këtij qarku janë shprehur se edhe pse vendimi i qeverisë për kalimin në pronësi të tyre të sipërfaqeve pyjore është mirëpritur, mungesa e hartave territoriale të shkallës 1 : 2500 bën që ata të ngurrojnë në marrjen në dorëzim të këtyre sipërfaqeve. Drejtues të njësive të qeverisjes vendore sy komunat Gur i Zi, Dajç, etj., janë shprehur se nuk do të firmosin në tryezë marrjen në dorëzim të pyjeve e kullotave që u janë dhënë nga qeveria, pa i parë ato konkretisht në terren dhe pa pasur hartat territoriale përkatëse. Sipas tyre, pa harta është e vështirë të caktohet kufiri i ndarjes së këtyre sipërfaqeve për çdo njësi të qeverisjes

## Në Qarkun e Shkodrës

A. DUSHI

vendore dhe kështu mund të lindin mosmarrëveshje e të tjera probleme. Po ashtu, ka rezultuar se jo e gjithë sipërfaqja pyjore që në letër u është kthyer si sipërfaqe pyjore njësive të qeverisjes vendore, të jetë e tillë, pasi ka raste kur nga evidentimi i bërë nga komunat del se në këtë sipërfaqe nuk ka asnjë pemë të mbjellë. Për të gjitha këto, kryetarët e këtyre njësive kanë kërkuar sjelljen e hartave nga drejtoria e shërbimit pyjor, e cila i ka pasur në pronësi këto sipërfaqe deri tani dhe ngritjen e grupeve të punës të përbashkët për evidentimin real në terren të këtyre sipërfaqeve. Sipas specialistit të pyjeve, Islam Laçaj, hartat që kërkohen nga drejtuesit e komunave dhe bashkive nuk mund të realizohen teknikisht. Në qarkun e Shkodrës janë transferuar në pronësi të komunave e bashkive, 158 000 ha pyje, ku rrethi Shkodër ka marrë 51.640 hektar, Malësia e Madhe 53.151 ha dhe Puka 53.965 ha. E llogaritur në vlerë monetare, kjo pasuri është vlerësuar në 23 miliardë e 813 milionë e 628 mijë lekë.



# KOMPENSIMI, GATI 42 MIJË HA PYJE

Vijon nga fq. 1

madhe e gjelberuar. Së katërti, janë rritur investimet në pyje dhe pyllëzime. Në sezonin e mbjelljeve të këtij viti u mbollën rreth 1 milion fidane pyjore, gje që nuk ka ndodhur asnjehere këto 20 vjetet e fundit. Dhe, së pesti, është një fazë e re, e cila do të fillojë tani, organizimi i Sherbimit Keshillimor. Kjo meqë do të kalojë në mase pyjet e kullotat nga shteti të komunat dhe këto të fundit kanë nevojë për konsulence, ndihmë profesionale e keshillim për ta administruar në mënyrë sa më racionale këto pasuri të madhe, që po marrin. Në prag të fillimit të këtij transferimi masiv të pyjeve në pronësi të komunave, struktura e pronësive ka qenë e tillë. Rreth 95 % e pyjeve dhe kullotave i perkisnin shtetit dhe vetëm 5 % privatit, që u është kthyer prona mbi bazen e dokumenteve që kanë paraqitur. Pas një pune studimore e parapergatitore prej 5-6 muajsh, pune që filloi në mesin e vitit 2007, u bë e mundur që të merren 327 vendime dhe janë transferuar po në kaq komuna e bashki fondi pyjor, që perben 60 % të sipërfaqes së pyjeve e kullotave që ka vendi. Aktualisht, me vendimet që janë marrë, janë transferuar rreth 700 mijë ha, duke shtuar këtu edhe 240 mijë ha kullota, që kanë qenë transferuar gjatë gjithë kësaj periudhe prej 17-18 vjetësh. Pra, janë rreth 900 mijë hektare pyje e kullota të transferuara.

**Pak me parë theksuat se vetëm 5 % e sipërfaqes pyjore dhe kullotave është në duar të privatëve. Tashmë, nga 900 mijë ha e transferuar, a do të jetë kjo sipërfaqe një potencial më tepër për kompensimin e ish-pronarëve, a mendohet që kjo t'u kalojë një pjese kësaj kategorie?**

Për sa i përket kësaj pike është menduar një zgjidhje tjetër. Aktualisht, 60 % e pyjeve dhe kullotave u takojnë komunave dhe bashkive, 5 % pronareve private dhe shteti ka mbajtur 35 per qind të fondit pyjor, nga 95 per qind që kishte një vit më parë. Kryesisht në pronësi të shtetit kanë mbetur parqet kombëtare, zonat e mbrojtura dhe pisha bregdetare, e cila është një pishe e mbjelle, e kultivuar dhe për momentin nuk është menduar që kjo t'u kalojë komunave e bashkive. Në lidhje me fondin për kompensimin e pronarëve, Ministrisë së Ekonomisë, e cila është përgjegjëse për këto pune, i janë

vene në dispozicion rreth 42 mijë ha me pyje, të cilat janë aktualisht në pronësi të shtetit. Për ata që do të fitojnë të drejtën mbi bazen e dokumenteve që t'u rikthehet prona apo t'u kompensohet prona janë 42 mijë ha në dispozicion, të shtrira në të gjithë vendin. Pra, edhe kjo rrugë apo ky shteg është i hapur.

**Pas kalimit të gjithë këtij fondi në bashki e komuna, cili do të jetë roli i Dikasterit për mbrojtjen e këtyre sipërfaqeve?**

Ministra do të vazhdojë të ketë rol primar në këto çështje. Nëse pari, përmes ofrimit të disa shërbimeve që nuk kanë ekzistuar më parë, apo deri më sot, siç është ai Keshillimor. Besoj se drejtuesit e bashkive dhe komunave do të ndodhen përballë vështiresive pas marrjes nën administrim të kësaj pronësie dhe ata kanë nevojë për keshillim, për legjislacion për ta përvetësuar e interpretuar drejt atë. Dhe me pas kërkohet zbatimi, ndaj në sigurojmë për krahasim dhe mbështetje të DSHP që janë në rreth. Do të kenë nevojë për hartimin e planeve të menaxhimit dhe kjo do t'u ofrohet nga këto drejtori mbi bazen e një skeme të caktuar, duke kontraktuar specialiste dhe eksperte në shoqatat e pyjeve. Do të kenë nevojë për ndihmën e policisë pyjore dhe për shumë shërbime të tjera, që do t'u ofrohen. Po kështu, do të ketë edhe një rekomandim nga ana jone që çdo komune, sipas madhësisë së pyjeve e kullotave, të përcaktojë një deri dy persona në administratën e komunes, që të tregojnë kujdes për këto pune, të merren me zbatimin e legjislacionit. Pra, atë pune që ka bërë DSHP, tani do ta bëjnë komunat me personelin e tyre. Njëkohësisht, do t'u rekomandojmë qarqet që të krijojnë seksione të veçanta për pyjet e kullotat me dy deri tre persona. Po ashtu, do të vazhdojë kujdesi për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri dhe shpresojmë që tani edhe interesimi e ndergjegjësimi i komunitetit në zonat rurale të jete



me i madh, sepse ka të bejë me pronën e tyre.

**Për sa u përket procedurave të pyllëzimeve të reja, si do të ndiqet; do të jetë komuna a bashkia që do të kryejë këto procedura apo Ministria?**

Politikat e rritjes së sipërfaqeve të gjelbra dhe të pyllëzimeve do të vazhdojë t'i bëjë kjo Ministria, por komunat e bashkitë kanë detyrimet e tyre. Kalimi i kompetencave pyjore komunave e bashkive është një nga reformat me të mëdha të kryera në Shqipëri këto 18 vjet. Personalisht do ta rendisja pas privatizimit të tokës bujqësore, kjo është reforma e dytë me e madhe e bërë këto vite, por me një intensitet me të madh, për fat të keq reforma që është bërë për ndarjen e tokave ka ende probleme të pazgjidhura.

**Sa do të ndikojë kjo shpërndarje në rritjen e cilësisë së mjedisit?**

Une besoj që ky shprehim i shteti dhe pronësimi i komunitetit, pra komunave e bashkive, do të shërbejë kryesisht në dy drejtime. Së pari, në zbutjen e varferisë, në rritjen e të ardhurave, në përmirësimin e cilësisë së jetes, përmes mundësisë me të madhe që u krijohet komunave e bashkive, automatikisht banorëve të këtyre zonave për të siguruar drutë e zjarrit, lëndet e ndërtimit për nevojat e tyre, si dhe më shumë të ardhura në bazen e shfrytëzimit të pyjeve dhe produkteve pyjore sipas planeve të menaxhimit. Po edhe për të mbrojtur pyjet nga zjarret besojmë se do të ketë me shumë kujdes e angazhim. Pra me shumë pyje do të thotë sipërfaqe me e madhe e gjelberuar, cilësi jete me e mire dhe ajër i pastër. Dua të theksoj edhe një klasifikim shumë të lakmueshëm që ka fituar vendi ynë në rangun botëror për problemet e mjedisit, por këtu një kontribut të veçantë kanë pyjet. Shqipëria është klasifikuar e 25 në listën botërore për sa i përket cilësisë së mjedisit në teresi. Kjo është konfirmuar në janar të këtij viti, nga këto institucione ndërkombëtare, por është rikonfirmuar edhe një herë tani se fundi nga revista prestigjioze amerikane "Nees eek", e datës 28 qershor.

# NGA PYJET - PËRFITIME TË PËRBASHKËTA, PËR PYJET - PËRGJEGJËSI TË PËRBASHKËTA



Të jemi përgjegjës për arritjen e ekuilibrit të sektorit të pyjeve me sektorët e tjerë. Të jemi përgjegjës për vendosjen e ekuilibrit midis rolit ekologjik, shoqëror, kulturor dhe ekonomik të pyjeve, në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm.

Duke harmonizuar nevojat e njerëzve dhe të planetit për pyje, bota mund të përparojë në rrugën e qëndrueshmërisë dhe zhvillimit. Por, ky harmonizim nuk mund të arrihet vetëm nga komuniteti pyjor. Duhet ndërtuar ura lidhëse mes

sektorëve të shoqërisë dhe një sere aktorësh.

**Pyjet dhe kullotat kanë zhvillim të qëndrueshëm kur ka pjesëmarrje të plotë të qeverisjes vendore, popullatave lokale, biznesit, të gjithë atyre që përfitojnë, direkt apo indirekt, nga pyjet dhe kullotat.**

Në këtë fazë të re të integritit të Shqipërisë në strukturat europiane, pas një periudhe mbishfrytëzimi, mbikullotjeje e keqadministrimi të burimeve natyrore, pyjore e kullotave, merr rëndësi zbatimi i një strategjie të re për zhvillimin e sektorit të pyjeve dhe kullotave, çka do të ndikonte në përmirësimin e gjendjes, në rritjen e prodhimit të pyjeve.

Në themel të kësaj strategjie është menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore të pyjeve e kullotave, që nënkupton mirëqeverisjen dhe përdorimin e resurseve në një mënyrë dhe me një ritëm që ruan e siguron biodiversitetin, prodhimtarinë, aftësinë ripërtëritëse, vitalitetin dhe potencialin e tyre, për të përmbushur për sot dhe të ardhmen, funksionet ekologjike, ekonomike e sociale në nivel lokal, kombëtar dhe global, pa shkaktuar dëme në ekosisteme të tjera. (Citime të deklaratave të mëparshme të forumeve të ministrave në Europë për pyjet).

## Komente:

Për të realizuar këtë koncept, sot kërkohet të mbahen parasysh këto përparësi:

- Monitorimi dhe planifikimi i saktë i prerjeve tregtare. Shfrytëzimet vazhdojnë të kryhen vetëm në grumbujt pyjorë që kanë të nevojshëm e të domosdoshëm trajtimin me prerje për sigurimin e ripërtëritjes natyrore.
- Konsolidimi i procesit të transferimit të pyjeve e kullotave tek organet e qeverisjes vendore, hapat drejt kalimit tek përdoruesit tradicionalë, baza ligjore dhe sanksionimi i të drejtave të plota mbi përdorimin dhe pronësinë.
- Ruajtja dhe rehabilitimi i pyjeve e kullotave nëpërmjet rritjes së investimeve dhe nxitjes së nismave private.
- Vendosja e një sistemi monitorimi për ndjekjen në kohë të proceseve dinamike në pyje e kullota dhe për ndërhyrjen në kohë për rehabilitimin e tyre.
- Nxitja e nismave individuale private, të biznesit ose kolektive për ripyllëzimin e tokave të zhveshura dhe të abandonuara. Përdorimi i këtyre tokave për kultura të bimëve mjekësore apo drurëve pyjorë me rritje të shpejtë.
- Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i diversitetit biologjik në ekosistemet pyjore e kullotave.
- Ruajtja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i funksioneve mbrojtëse në mbarëshkrimin e pyjeve dhe kullotave (në veçanti mbrojtjen e tokës dhe atë të sasisë e cilësisë së ujërave).
- Ruajtja e funksioneve dhe shërbimeve të tjera social-ekonomike, si dhe sigurimi i përfitimeve të shumëfishta për shoqërinë, për brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

Zbatimi i një sërë konventash ndërkombëtare me objektiva mirëpërdorimit dhe ruajtjes së pyjeve e kullotave, mund të arrihet vetëm nëpërmjet pranimit e respektimit të parimeve të ruajtjes dhe zhvillimit të praktikave të një zhvillimi të qëndrueshëm të gjithë sektorëve që lidhen me to.

Shqipëria është një ndër vendet e para evropiane, që zbaton një Projekt të sekuestrimit të karbonit. Janë mundësitë për përfshirjen e një sipërfaqje më të gjerë në projekte të tjera në të ardhmen.

Përgatiti: GJON FIERZA

# Një jetë e tërë në shërbim të ekonomisë pyjore

Para disa ditësh u nda nga jeta Akile Pite, një nga figurat e shquara të Silvikuturës shqiptare. Familja, të afërmit, miqtë dhe kolegët e përcollën me pikëllim të thellë për në banesën e fundit.

Akileja lindi në Kuçovë në vitin 1933, por origjina e tij ishte nga Sheperi i Zagorisë. Për Zagorinë fliste gjithmonë dhe kishte mall e dashuri të veçantë. Këtë e shprehte disi me humor, edhe kur thoshte "më mirë shkoj e i kaloj pushimet dhe kënaqem në Sheper se sa në Paris".

Pasi mbaroi me rezultate të shkëlqyera arsimin e mesëm, kreu detyrimin ushtarak dhe më pas vazhdoi studimet e larta në Rumani në specialitetin e inxhinierisë pyjore.

Me t'u kthyer në atdhe emërohet në ish-Ndërmarrjen Pyjore Tiranë, në sektorët e trajtimit të pyjeve, kadastrës pyjore dhe erozionit.

Akileja i perket atij brezi intelektualësh të sektorit të pyjeve te viteve '60 që u kthyen nga studimet e larta të pajisur me njohuri të thella tekniko-shkencore, i gershetuan ato me praktiken shqiptare dhe arriten të realizojnë detyra shumë të rëndësishme, me gjithë kushtet e veshitura në të cilat punuan.

Nuk qendroi me shume se dy vjet në ndërmarrje dhe u transferua pedagog i ri në Fakultetin e Pyjeve, i cili kishte nevojë urgjente për pedagoge të afte për përgatitjen e kuadrove të lartë në vendin tone. Aty Akileja punoi për përgatitjen e leksioneve dhe teksteve, të cilat mungonin. Keshtu, krahas leksioneve që jepte, përgatiti tekste "Mbareshtimi i pyjeve", "Ekonomia pyjore", "Sistemimi i pellgjeve malore", etj. Por, pikërisht në kohën kur ishte formuar si pedagog dhe kishte fituar eksperiencë disa-vjeçare, duhet të "qarkullonte" në rrethin e Matit dhe të qendronte atje për 7 vite si drejtor i ndërmarrjes së pyjeve. Por, edhe në këto detyra ai u shqua për punë cilësore e

komplekse jo vetëm duke vene në praktikë njohuritë teorike, por edhe si organizator i shkelqyer. Te gjithë matjanet që kanë punuar me të dhe e kanë njohur, flasin fjalet me të mira. Ishte ai që me stafin e vet, përveç punimeve pyjore, ngriti rreth 30 stacione pompimi dhe rezervuar ujtitës.

Si në Fakultet edhe në Ndërmarrjen Pyjore, puna e tij është vlerësuar duke iu akorduar urdherin "Naim Frasheri" dhe "Urdherin e Punes të klasit të dytë".

Për një periudhë prej 10 vjetësh ka punuar në Institutin e Kerkimeve Pyjore, si bashkëpunëtor shkencor me problemet e silvikultures.

Akileja shquhej për punë studimore në fusha të ndryshme të silvikultures, midis tyre permendim: "Studim mbi ripërteritjen e pyjeve pas shfrytëzimit 20 vjeçar", "Studim mbi trajtimin e pyjeve të ahut dhe të pishes së zeze", "Studim lidhur me rehabilitimin ekologjik të lugines së Osunit, Shkumbinit e Paprit", "Studim mbi biodiversitetin dhe vlerat e tij për krahinën e Zagories", etj. Në vlerësim të këtyre studimeve fitoi edhe gradën "Doktor i shkencave".

Aktiviteti i Akiles është i gjithanshem. Ai ka referuar në shume takime dhe seminare, brenda e jashtë vendit, në Europë e deri në Amerikë. Ka marrë pjesë aktive në hartimin e ligjeve, rregulloreve e vendimeve për sektorin e pyjeve.

Në fushën e botimeve mund të permendim tekste "Mbareshtimi i pyjeve", "Sistemimi i pellgjeve malore", "Ekonomia pyjore", "Permirësimet pyjore", etj.



Puna e tij e madhe në shërbim të ekonomisë pyjore, duke filluar nga viti 1953 kur mbaroi shkollën e mesme e derisa jetoi, e ka bërë të njohur në gjithë personelin pyjor të vendit tone e më gjerë.

Akileja ishte i urtë e i mençur dhe me kulture të gjere në shume

fusha të jetes. Ai kishte karakter dhe sjellje shembullore. Ka patur ambicje për të kapur majat e shkences në fushën e tij. Çdo mendim apo propozim shkencor e argumentonte me fakte, pa qene konformist. Ishte i qetë nga natyra; nuk nxitohej kur jepte mendime apo keshilla. Ai nuk ishte karrierist, dëshironte të punonte ndershmerisht, ndaj bente jete modeste. Familja e tij ishte e thjeshtë nga e cila degjoheshin fjale të mira dhe të sjellshme. Femijet e tij janë të edukuar e shume të kulturuar, të cilet e nderojne emrin e babait të tyre.

Akileja ishte poliglot i shkelqyer; zoteronte shume gjuhe të huaja, si italisht, frengjisht, anglisht, rumanisht, fliste greqisht dhe rusisht.

Në shoqëri sillej si i barabarte, kishte humor dhe ishte i qeshur e

optimist. Prania e tij në takime apo gezime familjare e shoqerore e shtonte kënaqesinë.

Për Akilen mund të shkruash shume e mund të flasesh për kujtime të ndryshme dhe prapë të duket që nuk ke thënë aq sa duhet.

Vdekja e papritur e Akiles ishte humbje e madhe për familjen e të afërmit, për kolegët e bashkëpunëtorët. Por emri i tij do të mbetet në kujtesën tonë pa u shlyer.

**Panajot KOÇI, Aleko ALEKSI, Kristo QENDRO, Nehat Çollaku, Mevlan JAUPAJ, Felon HOXHA, Kujtim ASIMI, Mihallaq KOTRO, Arben PETTO, Kastriot SELIMI, Piro XHUMETIKU, Miço KOÇI, Simo KOÇI...**



Nga takimi i parë në Ditën e Inxhinierëve të Pyjeve të Shqipërisë

## Një delegacion suedes i pyjeve në Shqipëri

**Prof. Dr. ARSEN PROKO**

(I ngarkuar nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë si person kontakti)

Kontaktet ndërmjet Shqipërisë dhe Suedisë, në fushën e pyjeve, janë vendosur rreth 10 vjet më parë, por nuk janë konkretizuar me projekte për shkak të vështirësive financiare. Tani, situata ka ndryshuar dhe vendi ynë është në listen e prioritetëve të SIDA-s suedeze. Njihet fakti se SIDA tani mbështet Projektin e Zhvillimit të Burimeve Natyrore (PZHBN/NRDP). Po diskutohet për shtyrjen e mundshme edhe për një vit të Projektit dhe ndoshta në të ardhmen përpjekjet praktike në sektorin pyjor mund të lidhen me zgjatjen e këtij Projekti.

Pikërisht në këto rrethana delegacioni suedes vizitoi Shqipërinë me 22 - 27 shtator, i prituri nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

Grupi suedez përfaqësonte institucione pyjore shtetërore dhe private, Fakultetin e Pyjeve, Akademinë e Bujqësisë dhe të Pyjeve, por të gjithë të interesuar për misionin e tyre ndërkombëtar.

Qëllimi i grupit ishte të familiarizohej me kushtet e pylltarisë shqiptare, në mënyrë që të kuptonin kushtet dhe nevojat për zhvillimin e mundshëm të një aplikimi të përbashkët. Pra, qëllimi i vizitës ishte:

- o Të familiarizohej me pyjet, kushtet e pyjeve, legjislacionin pyjor dhe organizimin në Shqipëri;
- o Të familiarizohej me problemet në sektorin pyjor shqiptar;
- o Të familiarizohej me aktivitetet në vazhdim dhe harmonizimin e përpjekjeve të ardhshme me to;

Te zhvillojë një listë prioritësh të çështjeve perkatëse për ndërtim kapacitetesh në Shqipëri, të vlefshme për shtetin dhe agjencitë pyjore pylltarine komunale/private, si dhe për kërkimin e monitorimin; lista do të shërbejë si baze për zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit shqiptaro-suedes.

Grupi suedes udhëhoqej nga Prof. Dr. i merituar Folke Andersson (Akademia e Mbretërisë Suedeze e Shkencave Bujqësore dhe Pyjore). Të tjerë anetare të delegacionit ishin: PhD Lennart Ackzell (Këshilltar i Çështjeve Ndërkombëtare, Federata e Pronarëve pyjorë të Suedisë), Hon Prof. Dr. Esbjörn Andersson (Shkolla e Inxhinierisë Pyjore, Universiteti Suedes i Shkencave Bujqësore), Msc në pylltari Bo

Carlestål (Akademia Suedeze e Bujqësisë dhe pyjeve) dhe Bo Thor (Këshilltar, Njësia Nderkombëtare, Agjencia e Pyjeve Suedeze).

Delegacioni u takua dhe diskutoi me Akademikët Prof. Dr. Teki Biçoku (Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë) dhe Prof. Dr. Salvatore Bushati (Sekretar i Akademisë), me Prof. Dr. Lufter Xhuveli (Minister i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave), Dr. Taulant Bino (Zv/Minister i Mjedisit Pyjore dhe Administrimit të Ujërave), Dr. Nehat Çollaku (Drejtor i Politikave Pyjore e Kullësore), Prof. as. Dr. Thimaj Lako (Shoqata Kombëtare e Perdoriesve të Pyjeve dhe Kullotave Komunale), Drita Dade (Departamenti i Zhvillimit të Qendrueshem, Banka Boterore),

Carl-Fredrik von Essen (JPO Banka Boterore), Harko Kostner (SNV-Organizata Holandeze për Zhvillim), Margareta Nilsson (SIDA), Mehmet Metaj (Albaforecast), etj.

U organizua gjithashtu një takim dypalësh, ku u prezantuan organizatat suedeze dhe ekspertët shqiptarë parashtruan nevojat më të ngushta për zhvillimin e pylltarisë shqiptare, reformat e ndërmarra nga qeveria shqiptare në pylltari dhe çështjet më të rëndësishme objekt i një bashkëpunimi të ardhshëm shqiptaro-suedes.

Shumë i vlefshëm për delegacionin suedes ishte vizita në terren, e organizuar nga Drejtoria e Politikave Pyjore e Kullësore, në Komunën e Ulzës, ku janë transferuar sipërfaqe pyjore e kullësore në kuadër të NRD.

## Në Qarkun e Dibrës

## Arroret burim të ardhurash

Ruajtja, shtimi dhe shfrytëzimi racional i bimëve arrote kerkon se pari evidentimin e madhësisë së fondit të tyre në sipërfaqe, prodhim e biomasë, si dhe njohjen e strukturës së llojeve, vlerësimin e prodhimtarisë dhe marrjen e masave për trajtimin e mbarshtimitin e qëndrueshëm të tyre.

## Disa vlerësime për arroret

**Arra (*Juglans regia*).** Arra është pemë frutore shume e vjeter. Ne Qarkun e Dibres jane gjetur arra mbi njeqindveçare. Sipas te dhe- nave te fundit te sektorit privat, zonat dhe fshatrat më të populluara me arre jane Xibër, Kete, Macukull, Kurdari, Skenderaj, Lis, Gjallësh, Burgajet, Gurre e Madhe, Gurre e Vogel, Mishter, Fullqet, Dars, Cerruj, Patin (në Mat); Trebisht, Vernice, Terbac, Cerenec, Gjorice e Eperme, Gjurash, Kovashice, Homesh, Zogje, Topojan, Valikardhe, Ternove e Madhe, Sopot, si dhe komunat Arras, Zall-Dardhe, Sillove, Luzni, Muhurr, Kastiot e Tomin (në Dibër). Në keto fshatra ka nga 100 deri 1200 arra ne prodhim, me aftësi prodhuese 5-20 kg per rrenje, por ka dhe peme me mbi 50 kg fruta. Zakonisht arrët janë të shperndara. Por, megjithëse të shperndara ne luginat e lumenjve e të përrenjve, si dhe në fundet e arave, ato jane në zoterim privat të fermerëve që kanë tokën, të cilët marrin edhe prodhimin dhe, sipas pohimit të tyre, në shumë zona mbi 40 % e prodhimit përdoret për vete, për konsum e dhurata për familjet e larguara prej andej, kurse pjesa tjeter çohet në treg.

Arra ka nje vecori se ruhet per nje kohe te gjate.

Frutat e arres dallohen per vlerat e larta ushqimore. Ato jane te pasura me vitamina A, B, C, rreth 60 % vaj tepër ushqyes, etj. Po ashtu, frutat e arrës kanë pozitive edhe faktin që ruhen gjatë, mjafton që të vilen e seleksionohen në kohë, të thahen mirë (deri 12-14 % lagështi) dhe të mbahen në vende të thata e të ajrosura mirë.

**Gështenja (*Castanea sativa*).** Në Qarkun e Dibrës gështenja gjendet në pyjet natyralë afer fshatrave Kilobçisht, Kerçisht, Pocest, Grezhdan, Ushtelencë, Baz, Rukaj, Gurre, Mazhice dhe në disa pyje te ulet (cungishte) në Cetush, Ushtelence, Pejke, Pjece, Grezhdan, Pocest, Gurre, Macukull, Koms, Lis, ku ka masive gështenjash te perziera me lis, qe kane moshe te re dhe me dendesi te madhe, trajtuar pa kujdes per prodhim fruti.

Kushtet klimatike të zonës e bejne gështenjen kulture me shume rendesi edhe per faktin se ajo eshte mjaft fitimpruese. Rendesia e gështes qendron edhe ne faktin se fruti i saj ka vlera te larta

ushqyese (6 % proteina, 45 % yndyrna, 45 % amidon, 20 % sheqerna). Në sezonin e lulezimit, lulet e geshtenjes sigurojne ushqim shume te mire per bletet, mjalti i së cilës ka vlera te larta kurative per shume semundje. Lulezimi fillon në mesin e majit dhe shkon deri ne mesin e qershorit. Nga një ha geshtenje mund të prodhohet 50-120 kg mjaltë.

**Lajthia (*Corylus avellana* L.).** Pema e lajthise eshte ne forme shkurreje, 3-8 m lartesi dhe ka jetegjatesi rreth 60 vjet. Per vlerat e larta ushqyese, frutat e lajthise kërkohet nga tregu e sidomos nga industria ushqimore per prodhimin e embelsirave dhe çokollatave. Frutat permbajnë deri 79 % vaj, 18 % proteina dhe 3-10 % sheqerna.

Lajthitë në shumicen e rasteve jane të shperndara në shpatet e maleve e në lugina. Zonat me më shumë lajthi jane Staraveci, Pocesti, Popinara, Melani, Sllatina, Vlesha, Zalldardha, Macukulli, Bazi, Rukaj, Okshtuni, Arrasi, etj. Ndryshe nga geshtenjat, frutat e lajthisë ruhen më gjate, mjafton që të vilen në pjekjen teknike, të thahen mirë (12-14 % lagështi) dhe të vendosen ne vende të thata e të ajrosura.

## Arroret me vlera të shumta

**Prodhim fruti.** Në tregti në grupin e gujavorëve përfshihen frutat e arrës, lajthisë, bajames, gështenjës, pekanit dhe hikores (këto dy të fundit rriten në Amerikën Veriore). Disa nga këto lloje, përveç frutave, vlerësohen dhe për cilësinë e lartë të drurit, i cili mund të përdoret për rimeso, apo për lëndë punimi duke siguruar të ardhura shtesë nga shitja e lëndës kur këta drurë rrallohen apo zëvendësohen. Vendet më të përshtatshme për kultivimin e këtyre llojeve janë pjesët e poshtme të përrenjve e lumenjve, tokat aluvionale dhe ato skajore. Shumica e tyre kanë kërkesa për tokën dhe preferojnë taracat lumore e tokat aluvionale, ku lymi është grumbulluar gjatë shumë vitesh. Disa nga këto lloje janë shumë të ndjeshme ndaj herbicideve, prandaj duhet bërë shumë kujdes kur spërkatën dru-frutorët, që ndodhen afër tyre.

**Vlerat e arroveve për prodhimin e lëndës së punimit.** Drurët që zgjidhen për t'u mbjelle e shfrytëzuar nga një pyll privat, komunal, mund të përdoren e te shiten për përdorime të shumta, si për sharrim, kompensato apo rimeso, që gjen përdorim në prodhimin e mobiljeve të shtrenjta. Në drurët me vlerë të lartë industriale, nga llojet e vendit, përfshihen arra, gështenja, qershia e egër, frashëri, panjat, blinjët, lloje të ndryshme dushqesh, si dhe mjaft lloje halorë. Nga llojet e huaja

përmenden arra e zezë, liri-dendroni, etj. Drurët me vlerë më të pakët mund të shiten për prodhimin e letrës, apo për prodhimin dru zjarri. Në rast se pylli ka shumë pak drurë me vlerë industriale, mund të mbarështohet për prodhimin e druve të zjarrit, që mund të përdoren për plotësimin e nevojave të familjes ose për shitje.

**Vlerat e arroveve për mbrojtjen nga erozioni.** Rrënjët e durëve te arres dhe geshtenjes jane shume te zhvilluara sidomos ne thellesi, prandaj ne kushtet e terreneve tona fiksojnë tokën dhe e mbrojnë nga erozioni, ndërsa shtresa e gjetheve të rëna dhe lëgusha shërbejnë si sfungjer për thithjen, filtrimin dhe mbajtjen e ujit. Pavarësisht nga objektivi i mbarështimit, pylli mund të sjellë mjaft përfitim nga mbrojtja e tokës dhe ruajtja e ujit.

**Vlerat e arroveve per kafshët e shpendet e egra.** Disa lloje drurësh nuk kanë ndonjë vlerë. Por, nje dru i thare 100 vjeçar arre a gështenje jep nje sherbim shume te madh per folezimin e shpendeve te dobishëm. Keto shpende i bejne nje sherbim shume te madh fermes tuaj, duke ndikuar ne luftimin e insekteve dhe demtueseve te kulturave bujqesore. Për të siguruar një mjedis optimal për faunën në pronen tuaj duhet të keni dhe lloje të ndryshme drurësh e shkurresh, sidomos ato që prodhojnë lëndë e fruta, që konsumohen nga kafshët e zogjtë, ku me të rëndësishme janë arra, gështenja, lajthia, por edhe ahu për frutin e tij.

**Arroret për rritjen e vlerave estetike të pronës.** Një zone me drure te mbarështuar mirë mund të theksojë gjithashtu bukurinë e natyrës në fermën tuaj, duke rritur kështu vlerat e pronës jo vetëm në aspektin e prodhimit të frutit, lëndës drusore, por dhe në atë estetike.

Pjeset kryesore botanike per te cilat vleresohen keto bime jane: frutat e gjethet, por edhe pjesët e tjera.

Nga bimet qe vleresohen per frutat e tyre ne rrethet Diber, Bulqize e Burrel jane: arra, lajthia e geshtenja, por dhe trendafil i eger, dellinja e kuqe dhe e zeze, molla e eger, driza, xhirokulli, salepi, murrizi, etj.

Gjethet zakonisht grumbullohen kur jane pjekur plotesisht. Sezoni i grumbullimit te tyre perkon me sezonin e vegjetacionit qe perfshin pranveren, veren dhe vjeshten. Ato grumbullohen duke i keputur me dore nje nga nje ose me degeza. Ne rastin kur nuk ka perfunduar sezoni i vegjetacionit rekomandohet qe vjelja e gjetheve te behet deri ne masen 50%. Tharja e gjetheve eshte me e lehte se sa e luleve, pasi ato pjeserisht mund te thahen edhe ne diell. Nga bimet kryesore që vleresohen per gjethet

e tyre ne kete rajon jane: sherebela, arra, lajthia, hithra, murrizi, ferra e bute, trumza, etj.

Ka raste qe disa bime vlere-sohen edhe per pjese te tjera organike, si: levorja, zhgualli i frutave, etj., si psh levorja e arrës, zhgualli i geshtenjes, lendet e dushkut, të frasherit, etj.

Nga shfrytëzimi i materialit ekzistues, si dhe nga vezhgimet paraprake del se druret potenciale qe rriten ne rrethet Diber, Burrel e Bulqize jane: Lajthia (fruti, gjethe, lëvore); Arra (druri, fruti, gjethe); Gështenja (druri, fruti, gjethe). Gjate kerkimeve ne kadaster jane gjetur te dhena qe deshmojne per kultivimin e bajames, kryesisht ne rajonin e Tomin deri ne 43 rrenje, me nje prodhim mesatar 10 kg/rrenje.

## Strategjia e Federatës së Dibrës për zhvillimin e arroveve

\* Së pari, është e nevojshme që rritësit e këtyre llojeve (arroveve) të marrin njohuritë e duhura për të siguruar sa më shumë të ardhura nga mbarështimi i qëndrueshëm i tyre. Prandaj, në mjaft takime shumë përdorues e pronarë të fidanishteve, rritës të arroveve dhe specialistë të DSHP, kanë parashtruar idetë e mendimet e tyre për të ardhmen e këtij sektore. Nga këto diskutime ka dalë si domosdoshmëri bashkëpunimi më i mirë i specialistëve të këtyre kulturave me Shërbimin Pyjor të Rretheve, me Departamentet e Bujqësisë dhe me Pushtetin Lokal, për të njohur situatën, si dhe nevojat e fermerëve. Po ashtu, nënvizohet nevojat për trajnime teknike, si dhe njohja e përvojës më të mirë në trajtimin e arroveve brenda qarkut po edhe më gjerë.

\* Programi këshillimor të trajnojë pronarët e fidanishteve të arroveve, të krijojë parcela prove dhe parcela demonstruese për rritjen e arroveve, të krijojë edhe fidanishte për fidanët e shumëzimit. \* Programi këshillimor t'u japë rritësve e pronarëve të fidanishtëve teknologjinë për rritjen e arroveve. Po ashtu, të parashikojë edhe importimin e fidaneve dhe materialeve të shumëzimit nga vendet e tjera. Trajnime të kombinohen sipas nevojave të paraqitura.

\* Strategjia për përfshirjen e Federatës në të ardhmen në sektorin e arroveve të bëhet sipas modelit të sugjeruar për pyjet e gështenjave të rretheve të tjera (studimi i përvojave Tropojë e Pogradec). Bazë për këtë të shërbejnë rezultatet e arritura në parcelat demonstruese të ngritura në pyjet e gështenjave të vendit, plantacionet dhe fidanishtet e gështenjave; në pyjet e arrave të vendit, në plantacionet dhe fidanishtet e arrave, në fidanishtet e lajthive. Në këto vende këshillohet të organizohen kurset e trajnimit, ku të zhvillohen orë

mësimi për të demonstruar praktikën më të suksesshme. Rritësit e arroveve të marrin të gjitha njohuritë për të nxjerrë sa më shumë të ardhura nga mbarështimi i qëndrueshëm i arroveve të veta.

\* Ka ardhur koha për të ndryshuar gjithçka për menyren e trajtimit dhe mbarshtimit te lajthisë, pasi ka shumë rezerva. Nga studimet e bëra ndër vite dhe nga përvoja e del se po të mbrohen zonat me lajthi, prodhimi minimal që merret sot (50-100 kg/ha) mund të rritet në 400-600 kg/ha.

\* Edhe për gështenjat kërkohet më shumë vëmendje. Aktualisht në mëse 300 ha gështenja te perziera me dushk mund të kete mbi milion drurë geshtenje, qe kane nevojte urgjente per nderhyrje me rrallime, kujdesime, shkalbezime, luftim kanceri dhe ne disa plantacione edhe per mbrojtje nga prerjet e kullotjet, si ne Tomin, Grezhdan, etj.

\* Së fundi, marketingu i këtyre produkteve në tregun e brendshëm favorizohet nga cilesia e mirë e tyre, nga pamja dhe ambalazhi. Por, fermaret tane fare pak ose aspak jane angazhuar ne aktivitete te tilla marketingu, si seleksionimi, ndarja në cilësi, paketimi, etj. Ndryshimi i kesaj situate, pra rritja fillimisht e pranisë se mallrave vendase ne tregun tonë e më pas në tregjet e vendeve te rajonit, kërkohet vëmendje të veçantë.

\* Ulja e shkalles se fragmentimit nepermjet konsolidimit plantacioneve me lajthi e geshtenje, gjallerimi i sistemit te qiramarrjes, shtimi i transakcioneve te shitblerjes se tokes dhe forcimi i shoqatave te fermereve, do të kontribuojnë ne rritjen e nivelit te prodhimit.

Te gjitha keto do të krijojnë kushtet për specializimin e ekonomive fermere, rritjen e shkalles se cilesise se prodhimeve. Ne keto rrethana do te pritet edhe nje aktivitet me i zgjeruar marketingu. Fermeret do te kene mundesi te aktivizohen ne me shume aktivitete per shtimin e vleres, çka do te thote praktika me te mira marketingu dhe rritje e te ardhurave te tyre.

Berja realitet e gjithçkaje që trajtuam në këto radhë, do te shenonte nje kthese ne fizionomine e prodhimit dhe te marketingut te produkteve te arroveve ne qarkun e Dibres.



# Bimë të egra mjekësore, ngjyruese

LUIGJ SHYTI

## dhe të ngrënshme në Theth

Vijon nga numri i kaluar

**B**imët mjekësore që përmendëm numrin e kaluar, veprojnë kundër arteriosklerozës, tensionit të lartë e të ulët të gjakut, përmirësojnë qarkullimin venoz, ngushtojnë enët e gjakut periferike, janë kundër temperaturave të larta, kundër etheve, për forcimin e rritjen e flokëve, kundër sëmurjes së bajameve, kundër gripit, kundër koagulimit të gjakut, kundër hemorragjisë, nxitin formimin e rruzave të bardha të gjakut, veprojnë kundër pakësimit të qumështit të gratë me fëmijë në gjë, kundër djersitjes së tepërt, për rritjen e rrjedhjes së gjëndrave të zorrëve dhe të pankreasit, për nxitjen e djersitjes, për pakësimin e qumështit të gratë me fëmijë në gjë. Bimët mjekësore të përshkruara në këtë punim veprojnë edhe kundër acarimeve të mukozave të gojës, kundër ekzemës, djegieve, morthit, kundër shtypjeve e goditjeve në pjesë të ndryshme të trupit, kundër pezmatimeve lokale, kundër lyetheve, kanë veprim rrudhës e kundër skuqjes së lëkurës, zbutës. Gjithashtu, përmirësojnë gjendjen e përvetimit dhe shpërvetimit në organizëm, kundër çrregullimeve e sëmundjeve të mëlçisë, për të ndihmuar prodhimin e tëmthit, veprojnë kundër astmës, kundër bronkitit, kundër kollës, kundër dhembjeve me origjinë nervore, kundër marrjes së mendve, kundër pagjumësisë, nxitin sistemin nervor qendror, rregullojnë në çrregullimet e proceseve gjenitale të femrat. Bimët mjekësore veprojnë kundër reumatizmit, luftojnë rrufën, përdoren kundër dhembjeve të stomakut, ndihmojnë në shtimin e

lëngut të stomakut, janë anti-ulceroz, veprojnë kundër të vjedhave, veprojnë kundër shtrëngimit të muskulaturës, kundër pezmatimit të syve, kundër zmadhimit të shprekës, kundër çrregullimeve të fshikëzës së tëmthit, kundër gurëve në tëmth e veshka, kundër acarimit të veshit, përmirësojnë qarkullimin e gjakut, gjallërojnë organizmin, janë kundër diarresë, kundër kapsllëkut, kundër majasëllit, kundër parazitëve kundër insekteve etj.

I përmendëm këto përdorime për të treguar edhe një herë se sa vepruese janë bimët mjekësore në përgjithësi dhe ato që kemi marrë në studim në veçanti. Duhet të theksojmë se secila bimë apo grup bimor ka përdorimin e saj. Një studiues grek quan çdo bimë një mjek.

Në listën e bimëve të botuar numrin e kaluar, përfshiheshin edhe rreth 50 bimë të egra, që janë të ushqyeshme e që mund të përdoren për ushqim. Kjo është një pasuri tjetër shumë e rëndësishme, përveç të tjerash edhe se rriten në kushte natyrore dhe janë plotësisht bio. Si të tilla mund të perëndim: Këputja e arave, fieri mashkull, lertha, lajthia, molla e egër, qershia e egër, dardha e egër, vesi e butë, vesi e egër, hitha, lëpjeta, nena, tharbçi, murrizi, kulumbria, manaferra, mjedra, boronica, drethe, bar bostani, etj.

Duhet bërë kujdes në përdorimin e bimëve të egra si për mjekim dhe për t'i ngrënë, sepse mund të shkaktojnë helmime me pasojë të rënda, prandaj ato duhet përdorur në mënyrë të studiuar.

Në grupin e bimëve që përmendëm përfshihen edhe afër 40

lloje që në mënyrë të veçantë, kombinuar me të tjera apo me përbërës kimikë, japin ngjyra shumë të bukura e të qëndrueshme. Të tilla mund të përmendim ngjyrën e kuqe, jeshile, kafe, qielli, gri, portokalli, e zezë, bezhë, e verdhë, e murrme, etj. Boja e përfutur nga këto bimë përdoret për të ngjyrosur leshin, lëkurën, pambukun, verërat, likernat, pijet e tjera alkoolike dhe janë plotësisht të pastra e të garantuara. Këta ngjyruer nuk dëmtojnë në asnjë rast shëndetin e konsumatorit.

Duke ndjekur vetitë e këtyre bimëve shikohet se një pjesë e mirë e tyre kanë dy e më shumë përdorime.

Në florën e shumëllojshme të Thethit disa mund të përdoren edhe si bimë zbukurimi në parqe e lulishte edhe në qytete, si p.sh. Vulfenia e Baldaçit, Zambaku Shqiptar, Karafili i egër, Shtogu i kuq, Bozhuret, etj.

Malësorët, nga përvoja shumëvjeçare, kanë fituar njohuri për mbledhjen e bimëve mjekësore dhe industriale, që rriten në territorin e fshatit dhe më gjerë. Bimët më të shfrytëzuara gjatë viteve në Theth kanë qenë: Rrënjë sanze (bari i zemrës), Lule njëmijëfletësh, Gjethe dretheje, Gjethe mjedre, Boronica, Çaja, Çaja e egër (Teukël), Hitha, Agulçe, Bar peshku, Fieri i egër, Gjethe dhe kabllëshë arre, Gjethe lajthie, Dëllinjë e kuqe, Dëllinjë e zezë, Trumza, Lisna, Shtara, Xhërokulli, Salepi, Shqëma, Shelgu i bardhë, etj.

Domosdoshmërisht duhet që të ketë kritere për mbledhjen dhe tregtimin e këtyre bimëve, sepse duhet ta kemi të qartë se edhe

brezat e ardhshëm kanë pjesën e tyre dhe ne nuk kemi të drejta absolute mbi to. Këto kritere duhet të vendosen e zbatohen me ligj. Për analogji po përmend thënien e Bruntland: "Ne nuk e kemi trashëguar tokën nga stërgjyshërit tanë, vetëm e kemi pranuar në ruajtje për fëmijët tanë". Kështu duhet menduar për të gjitha pasuritë natyrore.

Dukagjini ka pasuri të madhe mbi tokë e nën tokë, por të gjithë së bashku duhet ta njohim, ta popullarizojmë, ta shfrytëzojmë dhe ta ruajmë për të ardhmen. Veçori janë pasuritë bimore që gjenden në natyrë, që njerëzit nuk kanë bërë shpenzime duke i trajtuar, por vetëm i kanë shfrytëzuar. Koha kërkon që edhe për këto duhen bërë investime për të rritur kapacitetet e tyre, për një trajtim shkencor për sot e për të ardhmen. Jo vetëm bimët endemike, që nuk duhet të preken në asnjë mënyrë, përkundrazi duhet të mbrohen rreptësisht, por edhe të tjera, që përcaktohen, siç thuhet, në librin e kuq, të cilat janë në kufirin kritik për t'u zhdukur,



duhet të mbrohen në mënyrë të ndërgjegjshme e të përhershme.

Sipas një deklarate të përfaqësueses së GTZ në Shkodër të kohëve të fundit, sipas një projekti, këtë vit do të fillojë kultivimi i sanzës (*Gentiana lutea*) dhe agulçes (*Primula officinalis*) diku në Shalë. Është shumë kënaqësi një gjë e tillë dhe urojmë që të realizohet sa më mirë. Projekte të tilla do të ndihmonin edhe në ruajtjen e trajtimin shkencor të këtyre bimëve, por edhe në punësimin dhe rritjen e të ardhurave për banorët, do të shtonin edhe numrin e turistëve.

Biologët mund e duhet të bëjnë sa më shumë të njohur gjallesat që rrezikohen, të tregojnë mënyrat e kultivimit të tyre, me qëllim që të mbrohen ato dhe natyra e bukur dhe e pasur e Dukagjinit.

Për të mbrojtur mjedisin, së pari nuk duhet të dëmtohet ai, është një porosi shumë e vjetër.

Turizmi natyror nuk ka se si të kuptohet pa gjallesat. Atëherë këtë pasuri të paçmuar që kemi duhet ta vëmë në shërbim të turizmit, si faktor kryesor për zhvillimin e kësaj zone, për të cilin kemi shumë nevojë.

Në këtë shkrim nuk jam marrë me dendësinë e këtyre bimëve e masën dhe as me mënyrën e grumbullimit e përpunimit të tyre, por jam përqendruar në llojshmërinë si material biologjik dhe, shkurtime, për vlerat e përdorimit të tyre. Për më gjerë besoj se në të ardhmen e afërt do të mund të publikohet një botim me të dhëna më të plota, pasi pothuaj është i përfunduar.

## Kur e imponon mospërshtatshmërinë

Demokracia, një fjalë e lakmueshme, e përdorur që nga lashtësia, por sot e pazonja t'i rezistojë ekonomisë së tregut, e cila, që të lulëzojë, sjell në pushtet militantët. Këta të fundit strukturojnë një administratë të kastruar e të llastuar, të cilën e përdorin si vegël për të ngrënë mjeshtërisht (personelin inxhinier-technik). Puna që bëjnë militantët është ose të spiunojnë dikë ose të vjellin për dikë. Për këtë paguhen, bilë shumë shtrenjtë! ... Deri kur? ...

Gusht, 2008

## Kur zen fill bujqësia

Kur njeriu mbolli farën në tokë dhe nga ajo doli bima, që filloi të ushqejë lopën – fëmija e pati të sigurtë shkëputjen nga qumështi i nënës, për t'u ushqyer nga ai i lopes. Të rriturit filluan të ushqehen me bukë. Në këtë kohë puna mori kuptim të plotë. Atëherë filloi vazhdimësia e organizimit në familje. Kështu po hidheshin themelet e kulturës së njerëzimit.

Le të mendojmë për një çast sikur në jetën tonë të mos ekzistonin bimët dhe kafshët e kultivuara dhe prodhimet e tyre! Atëherë do ta kuptonim rëndësinë e madhe jetike që ka kjo "makinë" e gjallë, e cila, si një instrument madhështor na rregullon jetën tonë ...

### Të jesh vetvetja

Eshtë e vërtetë që çdo individ është i ndryshëm nga tjetëri. Çfarë do të thotë se çdo përpjekje për të qenë si gjithë të tjerët është e dështuar ...

### Kur vendimi është i drejtë

Për të arritur atë që të duhet, merr guximin e braktis pa dhimbje atë që nuk të duhet ...

### Të kuptuarit e jetës

Shumë njerëz e kuptojnë me vonësë se jeta nuk është fat, por është art ...

### Endrra e jetës

Dëshirat mund të mbeten për gjithnjë endërr nëse nuk përpiqemi vazhdimisht, me vullnet e zgjuarësi t'i kthejmë në realitet ...

### Kur i përkushtohesh vetes dhe tjetërve

Eshtë mirë të jesh "nënë", po pa harruar kurrë se edhe ti vet je njeri ...

nga AHMET OSJA



## FOREST TRANSFER TO COMMUNES THE MAIN REFORM IN FORESTRY

The transfer of the forest fund to the local government units, is one of the greatest reforms made in Albania during these 18 last years, just after the denationalization of the agriculture land. This is what the minister of Environment, Lufter Xhuveli, announced in an interview of his, appreciating this process. By his announcement, with this reformation it will be given the possibility to the citizens, town halls and districts to increase their income, and also to improve the quality of the environment.

On the other hand, the Ministry of Environment has given private property of about 42.000 hectares of the forest fund to the citizens, which will serve as compensation ...

Page 1, 4

## Medical wild plants, with pigment and eatable in Theth

Luigj SHYTI



Theth, one of the pearls of Albanian nature is located in the North part of Dukagjin, in a very beautiful valley, surrounded by high mountains at a height up to 2570 m above sea level (Radohina), where the snow is everlasting.

It is thought that in Theth territory exist about 1600 kinds of plants (almost 50% of the plants registered in Albania or about 14.5% of the Europe flora, of 11 000 identified kinds). Among them also endemic plants such as Vulfenia of Baldaç, Albanian lily and Dorfler Llapoi etc...

Page 7



## NACFP member of CEPF – Confederation of European Private Forest Owners NACFP is member of CEPF

CEPF is the representative of family forestry in Europe, and aims at enhancing the values of private property through sustainable forest management. CEPF assists and strengthens national forest owners' organizations in Europe to maintain and enhance an economically viable, socially beneficial, culturally valuable and ecologically responsible sustainable forest management. CEPF represents 16 million family forest owners owning approximately 100 million hectares of forest land in 24 European countries.

### KURORA E GJELBËR

Gazetë e Shoqatës Kombëtare të Pyjeve e Kullotave Komunale, Tiranë

Këshilli Botues:

N. Çollaku, Th. Lako, M. Kotro, J. Male, F. Memeli, A. Diku.

Kryeredaktor: AHMET OSJA

Zv.kryeredaktor: FERDIN LIÇAJ

Redaksia: V. Muharremaj, H. Kola, Gj. Fierza, Z. Ymeraj.

Redaktor përgjegjës: V. Hoxha

Adresa: Rruga "Sami Frashëri", Nr. 4, Tiranë

Mobile: 068 23 23 360; 069 21 11 333; 068 21 42 098

e-mail: velihoxha@yahoo.com

kurora\_gjelber@yahoo.com

www.shkpkk.org



The International Land Coalition is a global alliance of intergovernmental, governmental and civil-society organizations. The Coalition works together with the rural poor to increase their secure access to natural resources, especially land, and to enable them to participate directly in policy and decision-making processes that affect their livelihoods at local, national, regional and international levels.



Connecting People's Capabilities



# About the visit of Sweden delegation in Albania

Prof. Dr. ARSEN PROKO

(Contact person of Albanian Academy of Sciences)

Contact between Albania and Sweden, in forestry field, were established c.a. 10 years ago but not concrete projects were achieved due to funding difficulties.

Now the situation has change and the Albania is on the priority list of the Swedish SIDA. All of us know, SIDA is at present supporting Natural Resource Development Project (NRDP). A one year prolongation of the project is under the discussion and possibly future Swedish practical efforts within the forestry sector may be linked to a prolongation of the NRDP.

In these circumstances a Swedish delegation has visited Albania from 22 to 27 September 2008, hosted by the Albanian Academy of Sciences.

The visiting Sweden group represented state and private forestry institutions, Forest Faculty as well as Swedish Academy of Agricultural and Forestry, but all of them had international interests on their agenda.

The aim of the group was to be familiar with forestry conditions in Albania, in order to understand conditions and needs for the development of a possible joint application.

The aims of the visit were:

- To be familiar with forests, forestry conditions, forestry laws and organization in Albania;
- To be familiar with the problems within the forestry sector in Albania;
- To be familiar with on going activities and harmonize coming efforts with them;
- To develop a priority list of topic relevant for capacity building in Albania valid for state and forest agencies, commune/ private forestry as well as research and monitoring; the list will may serve as a base for further development of Albanian-Swedish collaboration.

The Swedish group was headed by the Prof. Dr. emeritus Folke Andersson (Royal Swedish Academy of Agriculture and Forestry and Swedish University of Agricultural Sciences).

Other members of the Swedish Delegation were: PhD Lennart Ackzell (Senior advisor



International Affairs, Federation of Swedish Forest Owners), Hon Prof. Dr. Esbjörn Andersson (School of Forest Engineers, Swedish University of Agricultural Sciences), Msc Forestry Bo Carlestål (Swedish Academy of Agriculture and Forestry) and Forster Bo Thor (Senior advisor, International Unit, Swedish Forest Agency).

The delegation meet and discussed with Acad. Prof. Dr. Teki Biçoku (Head of Albanian Academy of Sciences), Acad. Prof. Dr. Salvatore Bushati (General Secretary of Albanian Academy of Sciences), Prof Dr. Lufter Xhuveli (Minister of Environment, Forests and Water Administration), Dr. Taulant Bino (Vice Minister of the Environment, Forests and Water Administration), Dr. Nehat Çollaku (Directory of Forests and Pastures Policies), Prof as. Dr. Thimaq Lako (Forest User Association), Drita Dade (Sustainable Development Department, World Bank), Carl-Fredrik von Essen (World Bank JPO), Harko Kostner (SNV-Netherlands Development Organisation), Margareta Nilsson (SIDA), Mehmet Metaj (Albaforest) etc.

A bilateral workshop was organized, where the Swedish organizations are represented and where the Albanian experts discussed for the important reforms in forestry, undertaken by the Albanian Government and the main topics to be object of Albanian-Swedish collaboration.

Very useful for the Swedish delegation has been the field visit organized by the Directory of Forests and Pastures Policies on Ulza Commune, where, on the framework of NRDP, the forest and pastures areas have been transferred.

Page 5